

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shkullaku: E dinim që Gjykata Speciale do të kishte pasoja për liderët e UÇK-së, çfarë u mor në shkëmbim?
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/17/shkullaku-e-dinim-qe-gjykata-speciale-do-te-kishte-pasoja-per-lideret-e-uck-se-ctfare-u-mor-ne-shkembim/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 20:01:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 20:01:01 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	76fa6ad28dd023d162b5261e9399c35c19192323a02e466dd0cfb3639c4639ca
TEKSTI	2e42566a6de17add2b3d6b65c5934dddfdc5e374288b6a2364d9222d5bd71b8
PAMJA	e87005a4e8ddefff16baf564449412f347478b0e596f3daf84ab15aa7d779395

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	87feee470a24ae91a687054581a561780c051979471e4bb23ecbc9ec4a260c01
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b36d3d1202e685b83ffcf611c8f22a5defe9644c370970134944b31e37e025b7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/87feee470a24ae91a687054581a561780c051979471e4bb23ecbc9ec4a260c01

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > [AKTUALITET](#)

Shkullaku: E dinim që Gjykata Speciale do të kishte pasoja për liderët e UÇK-së, çfarë u mor në shkëmbim?

22:01 : 17/09/2026 në [AKTUALITET](#), [POLITIKE](#), [RAJONI](#)

Gazetari Armand Shkullaku, ka folur për vendimin e Gjykatës Speciale të Hagës dhe pasojat politike që, sipas tij, lidhen me krijimin dhe funksionimin e saj.

I ftuar në emisionin 'Çim Peka LIVE' në SYRI TV, Shkullaku u ndal te mënyra se si u krijua Gjykata Speciale dhe te diskutimet që, sipas tij, ekzistojnë që në vitin 2015 për pasojat që ajo mund të kishte ndaj drejtuesve të UÇK-së.

Sipas tij, në atë kohë ekzistonte edhe argumenti se, nëse një mekanizëm i tillë nuk do të krijohet në atë formë, çështja mund të përdorej në një tjetër kontekst ndërkombëtar.

Më tej, ai ngriti një tjetër pikëpyetje: 'Kush ishte problemi pse u pranua? Çfarë u mor në shkëmbim? Se ti mundesh me pranë një presion shumë të madh, por ama merr diçka tjetër në shkëmbim.'

'Nuk u mor asnjë gjë. U bë presioni, u votua gjykata dhe iku', shtoi ai.

Lexo edhe:

[Sikur piktori ta ndihmonte Kosovën aq sa e mbështeti Beogradin, shqiptarët do të ishin sot më të fortë](#)

["Rama mori helikopterin..." / Bushati: Gjykata Speciale, iu bë dhuratë Serbisë dhe Rusisë](#)

'Të gjithë e dinim, që nga Edi Rama, që erdhi në 2015-n, e dinim shumë mirë që ky tribunal do të kishte pasoja për liderët e UÇK-së. Pra, e dinim që në duart tona po i jepnim një instrument dikujt për ta përdorur në një moment të caktuar si monedhë shkëmbimi.

Dhe alibia që unë ngrita ishte: shiko, po s'e bëmë ne këtu, do të na bëhet atje me Rusinë, në Këshillin e Sigurimit e të tjerë e të tjerë. Pra, me një shpresë që këtu mund edhe ta kontrollojmë, ama pasojat diheshin se kush ishte tribunali.

TË GJITHA



Shkullaku: E dinim që Gjykata Speciale do të kishte pasoja për liderët e UÇK-së, çfarë u mor në shkëmbim?

22:01 : 17/09/2026



Sikur piktori ta ndihmonte Kosovën aq sa e mbështeti Beogradin, shqiptarët do të ishin sot më të fortë

22:00 : 17/09/2026



"Nuk kam lobuar për veten"/ Berisha tregon prapaskenat e heqjes së ndalimit në SHBA

21:54 : 17/09/2026



Futbolli shqiptar në zi, ndahet nga jeta ish-lojtari i Villaznisë

21:51 : 17/09/2026



49 ditë protestë/ Qytetarët në Divjakë vijojnë kundërshtimin e bashkimit me Lushnjën

21:49 : 17/09/2026



"Rama mori helikopterin..." / Bushati: Gjykata Speciale, iu bë dhuratë Serbisë dhe Rusisë

21:43 : 17/09/2026



Me 200 km/orë për të dërguar 50 mln € drogë/ Si u zbulua banda shqiptare në Spanjë

21:30 : 17/09/2026

Patjetër që diheshin. Po orakuj nuk jemi ne me e ditur çfarë ka me ndodhur. Ne as akuzë s'kishim, as akuzë...

Diheshin se janë thënë, janë thënë nga të gjithë. Ne atëherë nuk e dinim akuzën, por kur rrinim në ambientet ku rrinim të gjithë, e dinim që kjo gjykatë, këto dhoma të specializuara, ishin një kërcënim serioz për disa nga udhëheqësit e UÇK-së, përfshirë vetë Hashim Thaçin.

Dhe megjithatë, nga presioni ndërkombëtar, se dhe Rama për shkak të atij presioni shkoi aty, për të treguar që unë kam ndikim ndër shqiptarët... Për shkak të atij presioni, të gjithë ulën kokën dhe e votuan.

Ky është fakt. Për shpirt, asnjë s'e kishte dashur. Ti, për të thënë që ti e ke dashur, sepse... për hir të asaj zbardhje fytyre, asnjë s'e ka dashur.

Po pse u pranua kur s'është dashur? Sepse ishte raporti ndërkombëtar, ishte shumë i madh. Kishte kaluar Dick Marty, bëri raport...

E para. E dyta, kush ishte problemi pse u pranua? Çfarë u mor në shkëmbim? Se ti mundesh me pranua një presion shumë të madh, por ama merr diçka tjetër në shkëmbim.

Nuk u mor asnjë gjë. U bë presioni, u votua gjykata dhe iku.

Dhe, meqë e mora fjalën për ta përfunduar, çështja është që ne kemi fatkeqësi shumë si popull, si komb, si të doni, që ne kur na ndodh një gjëmë, dimë vetëm të qajmë. Qajmë edhe me zë. Por asnjëherë nuk kemi nxjerrë mësim nga goditjet, tragjeditë që na ka dhënë historia.

Kurrë s'jemi ulur t'i analizojmë dhe të ballafaqojmë atë që tha Bushati: pse erdhëm deri këtu.

Dhe situata emocionale, patetike, frenezia, protagonizmi i sëmurë, përmende Milaimin që qante, qante Taulant Balla, kupton? Çfarë t'i them unë kësaj? Nga dramatikja, situata bëhet qesharake.

Njerëzit me mend duhet të ulen. Sa është dëmtuar dhe çfarë mundësish kemi pasur që një gabim që na ndodhi atëherë ta evitonim dhe si mund të ndodhë sot që mund ta evitojmë.

Çfarë presioni ndërkombëtar mund të bëhet sot, si nga Shqipëria, si nga Kosova, që ky vendim, ose të bëhet apeli sa më shpejt, ose cilat janë mundësitë ligjore për ta zhbërë gjykatën? A ka efekt prapaveprues nëse zhbëhet gjykata? A mund të shmanget votimi? A mund të organizohet një referendum?

Pra, këto janë argumentet që duhet të shtrojmë. Se për të qarë do qajmë, dakord. Puna është: çfarë nxjerrim ne nga kjo histori?

Tjetra. Nganjëherë protagonizmi politik, si ai që pati Rama atëherë — jo se dua t'ia vë fajin Ramës, se nuk ka lidhje me këtë punë — por protagonizmi për të treguar që te këta shqiptarët kam unë ndikim dhe shkojnë ta votojnë gjykatën speciale me helikopterë, me të thashë e të thashë.

Tjetra që, shiko, e bëjmë gjykatën speciale, s'kemi çfarë t'i bëjmë, po do bëjmë një marrëveshje për shkëmbim territoresh dhe i fusim dhe një amnisti. Dhe u tha që kjo amnistia do falte dhe gjithë krimet e luftës, e të tjerë e të tjerë.

Kjo çfarë provokon? Kjo provokon konflikte te ata që janë më të mëdhenj dhe, kur përplasen dy të mëdhenj, dihet se kush e ha.

Pra, këtu janë disa gabime që janë bërë.

Fut edhe këtë që unë jam gjithmonë këtu me Bushatin: jo gjithçka që të vjen nga përtej oqeanit duhet gëlltitur siç të qoftë, se e gëlltit siç të qoftë e të ngelet në fytyrë, tha Armand Shkullaku në SYRI TV.

Etiketa: armand shkullaku denim hage uck


Lajme të lidhura





Sikur piktori ta ndihmonte Kosovën aq sa e mbështeti Beogradin, shqiptarët do të ishin sot më të fortë

22:00 : 17/09/2026



"Rama mori helikopterin..." / Bushati: Gjykata Speciale, iu bë dhuratë Serbisë dhe Rusisë

21:43 : 17/09/2026



Hashim Thaçi reagon pas vendimit në Hagë: Do ta apeloj vendimin

18:21 : 17/09/2026



"Kur u njoha me të, ishte në burg" / Rrëfimi i gruas së Jakup Krasniqit: I kam premtuar se...

18:02 : 17/09/2026



Aktgjykimi i Hagës përballë historisë së luftës së Kosovës

17:50 : 17/09/2026



Diaspora shqiptare mbledhet në "Times Square" në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së

17:41 : 17/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

